

Prishtinë, 22/11/2006
Kodi i ZRrE-s: D_25_2006

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Mbi Energjinë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I_03_2006 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2006/2007”; dhe
4. Faktin që Ndërmarrja Komunale Publike (NKP) Zvecan nuk ka dorëzuar aplikacionin për tarifatat e ngrohjes për sezonin 2006/2007, në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRrE).

Ka vendosur që:

1. Të aprovojë tarifatat e ngrohjes për NKP Zvecan për tërë gjashtëmuajorin e sezonit të ngrohjes 2006/2007 siç është paraqitur në tabelën “A” dhe “B”; është vendosur që tarifatat të mbesin të njëjta si në sezonin e ngrohjes 2005/2006 për shkak të mos-dorëzimit të aplikacionit të tarifave dhe për pasoj mungesën e informatave relevante që duhej të përmbante aplikacioni.
2. Tarifatat e aprovuara do të publikohen nga ana e NKP Zvecan në njërën nga gazetatat kombëtare dhe lokale që qarkullojnë në Kosovë, brenda (5) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) do të përdorë të drejtat sipas ligjit, për të verifikuar të dhënat, llogaritë kontabël dhe faturat e NKP Zvecan, e gjithashtu do të bëjë bashkërendimin e tarifës aktuale (sezoni ngrohjes 2006/2007) me tarifatat e reja të projektuara për sezonin 2007/2008.
4. Gjatë sezonit të ngrohjes 2006/2007 NKP Zvecan mund të paraqesë para Zyrës së Rregullatorit për Energji propozimin për ndryshime të arsyeshme të tarifave të aprovuara nga ZRrE-ja në pajtim me Udhëzimin e Përkohshëm I_03_2006 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2006/2007”.
5. NKP Zvecan ka të drejtë ankese ndaj vendimit të ZRrE-së duke dorëzuar raportin e plotë të dëshmuar brenda dhjetë (10) ditësh kalendarik pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimi të ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
6. Duke ju referuar paragrafit 1 të këtij vendimi, Bordi i ZRrE-së do të konsideroj të shqiptoj dënimin e duhur sipas Nenit 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Nenit 5.4 të Udhëzimit të Përkohshëm I_03_2006, për dështim të NKP Zvecan të dorëzoj informatat e kërkuara për shqyrtimin e çmimeve të ngrohjes qendrore për sezonin 2006/2007.

**TARIFAT E NGROHJES PËR NDERMARRJEN KOMUNALE PUBLIKE "ZVECAN"
PËR SEZONIN E NGROHJES 2006/2007**

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT E PA-NJEHSUAR

NKP "ZVECAN"		
Komponentet e Tarifave	Amvisri	Komerical dhe Institucional
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	PA	€0.10 / m2 për muaj
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	PA	€1.13 / m2 për muaj

PA: e Pa-aplikueshme

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT E NJEHSUAR

NPK "ZVECAN"	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes ne kW (komponenta fikse)	PA
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta fikse)	PA

PA: e Pa-aplikueshme

Inkurajojmë Ndërmarrjet e Ngrhjes Qendrore që të matin konsumin e ngrohjes nëpër nënstacione sa më shumë që të jetë e mundur përmes njehsorëve të kalibruar të ngrohjes, posaçërisht për konsumatorët komercialë dhe institucionet.

Bordi i ZRrE-së:

Nick Frydas, Kryesues,

Nysret Avdiu, anëtar

Merita Kostari, anëtare,

Naim Bejtullahu, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare